

VENDIM
Nr. 836, datë 28.10.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT E TË
PROCEDURËS PËR PAJISJEN, RIPËRTËRITJEN, REFUZIMIN DHE ANULIMIN E
LEJES SË PUNËS PËR SHËRBIME KONTRAKTUESE TË TIPIT “C/SHK”¹, SI DHE
TË TARIFËS SHTETËRORE PËR LËSHIMIN E KËSAJ LEJEJE PUNE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 71, pika 8, 86, pika 2, e 105, pika 1, të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të huajt i jepet leje pune e tipit “C/SHK” për shërbime kontraktuese, për një kohëzgjatje jo më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë brenda një viti kalendarik, nëse plotëson kriteret, si më poshtë vijon:

- a) plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 102, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar;
- b) ka një kontratë të rregullt pune për shërbime kontraktuese me punëdhënësin, përfutues të shërbimeve në Republikën e Shqipërisë për kategoritë e parashikuara në nenin 102, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

2. Të huajt i ripërtërihet leja e punës e tipit “C/SHK”, për shërbime kontraktuese, nëse plotëson parashikimin e pikës 1, të nenit 76, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, si dhe:

- a) plotëson kushtin e përcaktuar në pikën 5, të nenit 102, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar;

- b) ka një kontratë të rregullt pune, jo më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë për vitin në vazhdim, me një punëdhënësi, përfutues shërbimesh. Në rast të ndryshimit të punëdhënësit ose të kushteve të tjera të lejes së punës, kjo duhet të jetë bërë përpara paraqitjes së kërkesës për leje pune të ripërtëritur, me miratimin e strukturës në nivel qendror të AKPA-së, në zbatim të nenit 74, të ligjit për të huajt;

- c) punëdhënësi nuk ka kryer shkelje të legjislacionit të punës në vitin kalendarik pararendës.

3. Kërkesa për t’u pajisur me leje pune të tipit “C/SHK” paraqitet nga subjekti që përcaktohet në pikën 3, të nenit 102, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

4. Punëdhënësi paraqet kërkesën, nëpërmjet shërbimit elektronik të portalit *e-Albania*, për ta pajisur të huajin e kontraktuar nga ana e tij, për herë të parë, me leje pune të tipit “C/SHK”, si dhe dokumentacionin e mëposhtëm, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin nga noteri:

- a) kërkesën për leje pune për të huajin, me të dhënat personale, sipas formatit të dhënë në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

- b) kërkesën për plotësimin e vendit të lirë të punës;

- c) kopjen e kontratës individuale të punës për kategoritë e përcaktuara në nenin 102, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar;

- ç) kopjen e pasaportës së të huajt, ofrues të shërbimeve;

- d) prokurën apo autorizimin nga punëdhënësi, nëse aplikimi kryhet nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar;

- dh) Një fotografi të aplikuesit, të bërë jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, me

¹ Ky vendim i Këshillit të Ministrave përfaqëson përsëritje të direktivës 2006/123/EC, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e 12 dhjetorit 2006, për shërbimet në tregun e brendshëm. Numri CELEX 32006L0123, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian.

përmasa 47 (dyzet e shtatë) mm x 36 (tridhjetë e gjashtë) mm, të marra në plan me sfond të bardhë, të fokusuara dukshëm e qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me qëndrim neutral e sytë të hapur e të dukshëm.

5. Punëdhënësi, i cili kërkon ripërtëritjen e lejes së punës të tipit “C/SHK” për shërbime kontraktore, nëpërmjet portalit *e-Albania*, brenda 30 (tridhjetë) ditëve para përfundimit të lejes paraardhëse, paraqet dokumentacionin e mëposhtëm, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin nga noteri:

- a) kërkesën për leje pune për të huajin me të dhënat personale;
- b) kopjen e kontratës së punës;
- c) kopjen e pasaportës së të huajit, ofrues të shërbimeve;
- ç) prokurën, nëse aplikimi kryhet nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar;
- d) një fotografi të aplikuesit, të bërë jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, me përmasa 47 (dyzet e shtatë) mm x 36 (tridhjetë e gjashtë) mm, të marra në plan me sfond të bardhë, të fokusuara dukshëm e qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me qëndrim neutral e sytë të hapur e të dukshëm.

6. Kërkesa dhe dokumentacioni i përcaktuar në pikat 4 e 5, të këtij vendimi, i drejtohet strukturës në nivel qendror të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA). Struktura në nivel qendror e AKPA-së, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe vlerëson se ai nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 4, të këtij vendimi, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e aplikimit, i kërkon punëdhënësit plotësimin e tij, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

7. Struktura në nivel qendror e AKPA-së, pas paraqitjes së kërkesës nga punëdhënësi i përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi, verifikon të dhënat e punëdhënësit, të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, statusin “aktiv”, si dhe shlyerjen e detyrimeve lidhur me pagat e punonjësve, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga ana e punëdhënësit, pranë të cilit do të punësohet i huaji.

8. Struktura në nivel qendror e AKPA-së, pasi konstaton se vendi i lirë i punës nuk arrin të plotësohet me punëmarrësit nga tregu i brendshëm i punës, i parashikuar nga neni 84, i ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, dhe vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga punëdhënësi është i plotë apo pas plotësimit të tij nga ai, brenda afatit të përcaktuar, përmbush kriteret e përcaktuara në pikat e këtij vendimi, e pajis të huajin, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, me leje pune të tipit “C/SHK”, për herë të parë, sipas formatit të dhënë në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. E njëjta procedurë ndiqet edhe në rastin e shqyrtimit të dokumentacionit për ripërtëritjen e lejes së punës. Struktura në nivel qendror e AKPA-së e njofton në mënyrë elektronike kërkuuesin që të dërgojë me postë dokumentacionin origjinal, si dhe çdo dokument të listuar në pikat 4 apo 5, të këtij vendimi, në 1 (një) kopje dhe 3 (tre) fotografi, sipas përshkrimit më lart, dhe më pas po në atë adresë postare i dërgohet kopja origjinale e lejes së punës.

9. Struktura në nivel qendror e AKPA-së ia kthen kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur punëdhënësit, nëse ai nuk e ka plotësuar atë brenda afatit të përcaktuar në pikën 6, të këtij vendimi.

10. Struktura në nivel qendror e AKPA-së ia refuzon kërkesën për pajisje me leje pune të tipit “C/SHK” subjektit, i cili, megjithëse ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar, vlerësohet se nuk plotëson kriteret e përcaktuara në pikat 1, 2 e 7, të këtij vendimi.

11. Të huajit i refuzohet lëshimi i lejes së punës të tipit “C/SHK”, nëse vërtetohet njëri nga kushtet e përcaktuara në nenin 77, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

12. Të huajit i anulohet leja e punës e tipit “C/SHK”, nëse vërtetohet njëra nga situatat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 80, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

13. I huaji, të cilit i refuzohet ose i anulohet leja e punës e tipit “C/SHK”, ka të drejtën e ankimit, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 2, të nenit 81, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

14. Leja e punës e tipit “C/SHK” përfundon, nëse plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 78, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

15. I huaji, i cili pajiset për herë të parë me leje pune të tipit “C/SHK” dhe i përket kategorive të përcaktuara në nenin 102, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, para marrjes së lejes së punës, detyrohet të paguajë tarifën prej 4 000 (katër mijë) lekësh. I huaji, të cilit i rinovohet leja e punës e tipit “C/SHK” dhe i përket kategorisë së përcaktuar në pikën 5, të nenit 102, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, para marrjes së lejes së punës, detyrohet të paguajë tarifën prej 2 000 (dy mijë) lekësh.

16. Drejtoria, që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit në ministrinë e përgjegjëse që mbulon çështjet e punësimit, monitoron, në mënyrë periodike, procedurën e ndjekur nga struktura në nivel qendror e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive për dhënien e lejes së punës.

17. Vendimi nr. 67, datë 12.2.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës, për shërbime kontraktuese, të tipit “C/SHK””, shfuqizohet.

18. Ngarkohen ministria përgjegjëse që mbulon çështjet e punësimit dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PRIVAT C SHK i inputuar 0271020 [Read-Only] [Compatibility Mode] - Microsoft Word

File Home Insert Page Layout References Mailings Review View Acrobat

Times New Roman 10

1 Normal 1 No Spacing Heading 1 Heading 2 Title Subtitle Subtle Emphasis Intense Emphasis Strong Quote Intense Quote Subtle Reference Intense Reference Book Title Change Styles Select

Clipboard Font Paragraph Styles

ANEKSI I

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

REPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRY OF FINANCE
AND ECONOMY

DREJTTUAR:
TO:

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
NATIONAL AGENCY OF EMPLOYMENT AND SKILLS

FORMULAR-KËRKESË / APPLICATION
për lëshimin e lejes së punës që të llogaritet issuance of work permit to a foreigner

1. TË DHËNAT E PUNËDHËNËSIT INFORMATION ABOUT THE EMPLOYER

1. Emri i punëdhënësit
Name of the employer

2. Vendi dhe adresa e punëdhënësit
Set and address of the employer

3. Numri i regjistrimit në ISSH
Registration number in the Co Health Insurance Institute

4. Kodi fiskal NPT
Business activity code

a) Vendimi i gjykatës për njohjen e biznesit ose
Court Decision on Business Acknowledgment or

b) Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Biznesit
Extract from National Business Centre

5. Data e mesazhit e fillimit dhe e përfundimit të punës
Period for which the work permit is requested from to

6. Emërtimi i vendit të punës
Name of the job position

7. Kuota vjetore
Yearly quota

8. Punësimi personai
Seasonal employment

9. Migrimi ditor
Daily migration

2. TË DHËNAT E TË HUATIT INFORMATION ABOUT THE FOREIGNER

1. Mësimi
Surname

2. Emri
(Given name(s))

3. Emri i babait
Name of the parent

4. Datëlindja
Date of birth

5. Gjinia
Sex

6. Vendi dhe shteti i lindjes
Place and country of birth

7. Shtetësi
Nationality

8. Adresa e banimit në Shqipëri
Residential address in the Republic of Albania

9. Koli dhe emri i punësimit
Code and name of occupation

10. Kualifikimet
Skill qualifications

11. Aktiviteti shpirtëror
Casualty employed

3. DOKUMENTI I VLEFSHËM / VALID DOCUMENT

1. Lloji i dokumentit
Type of document

2. Numri
Number

3. Lëshuar në
Issued on

4. E vlefshme deri më
Valid until

5. Autoriteti kompetent
Competent authority

6. Lëshuar nga
Place and country of issuance

Vendi dhe data
(Place and date)

Emri i mbështetësit
(Applicant)

Page: 1 of 4 Words: 700 Albanian

Type here to search

10:19 AM
10/30/2020

PWKM C SHK i ripunuar dt27/10/20 [Read-Only] [Compatibility Mode] - Microsoft Word

File Home Insert Page Layout References Mailings Review View Acrobat

Clipboard Font Paragraph Styles

ANEKSI I

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

REPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRY OF FINANCE
AND ECONOMY

DREJTUAR: AGJENCIA KOMBËTARE TË PUNËSDIMIT DHE AFTËSIVE
TO: NATIONAL AGENCY OF EMPLOYMENT AND SKILLS

FORMULAR KËRKESË / APPLICATION
për lëshimin e lejes së punës një të huajt për sigurimin e tënd përmit të a foreigner

1. TË DHËNAT E PUNËDHËNËSIT / INFORMATION ABOUT THE EMPLOYER

1. Emri i punëdhënësit
Name of the employer

2. Vendi dhe adresa e punëdhënësit
Seat and address of the employer

3. Numri i regjistrimit në ISSE
Registration number in the Cr Health Insurance Institution

4. Kodi fiskal NIPT
Business activity code

a) Vendimi i gjykatës për njohjen e himanit ose:
Court Decision on Business Acknowledgment or

b) Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Bimësisë
Abstract from National Biome Centre

5. Data e menjshme e fillimit dhe e përfundimit të punës
Period for which the work permit is requested from to

6. Emërtimi i vendit të punës
Name of the job position

7. Kuota e punës
YES NO

8. Punësimi sezonial
YES NO

9. Migrimi ditë
YES NO

2. TË DHËNAT E TË HUAJT / INFORMATION ABOUT THE FOREIGNER

1. Mësimi
Surname

2. Emri
Given name(s)

3. Emri i babait
Name of the parent

4. Datëlindja
Date of birth

5. Gjinia
Sex

6. Vendi dhe shteti i lindjes
Place and country of birth

7. Shtetësi
Nationality

8. Adresa e banimit në Shqipëri
Residential address in the Republic of Albania

9. Kodi dhe emri i punësimit
Code and name of occupation

10. Kualifikimet
Skill qualifications

11. Aktiviteti fillejor
YES NO

3. DOKUMENTI I VLEFSHËM / VALID DOCUMENT

1. Lloji i dokumentit
Type of document

2. Numri
Number

3. Lëshuar në
Issued on

4. E vlefshme deri më
Valid until

5. Autoriteti kompetent
Competent authority

6. Lëshuar nga
Place and country of issuance

Vendi dhe data
(Place and date)

Emri i ishëm i aplikantit
(Applicant)

Page: 1 of 4 | Words: 700 | Albanian

Type here to search

10:19 AM
10/30/2020

